

**SALI KADRIA**

**MBI DISA ÇËSHTJE TË ADMINISTRIMIT POLITIK  
DHE FINANCIAR TË TERRITORIT TË SHQIPËRISË  
TË OKUPUAR NGA AUSTRO-HUNGARIA  
GJATË VITEVE 1916-1918**

Çështja e pranisë austro-hungareze në Shqipëri gjatë viteve 1916-1918, është trajtuar nga studiues shqiptarë<sup>1</sup> dhe të huaj<sup>2</sup>. Në këto studime ka pika takimi, por njëherësh edhe këndvështrime të ndryshme mbi karakterin e pranisë së Austro-Hungarisë në Shqipëri, si dhe për rolin dhe kontributin e saj në këto vite. Për këtë periudhë historike, krahas studiuesve shqiptarët huaj si, Tamara Scheer dhe Kurt Gostentschnigg, ndër të tjera kanë identifikuar edhe aspekte pozitive të ndikimit që pati Austro-Hungaria, për zhvillimin e shqiptarëve si në rrafshin kulturor dhe atë politik. Prandaj, kjo trajtesë synon të përqendrohet vetëm në disa

<sup>1</sup> Muin Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare 1914-1918*, botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë: 8 Nëntori, 1987; Ilir Kanini, *Arsimi në vitet e Luftës I Botërore – Zona e pushtimit Austro-Hungarez, 1916-1918*, Tiranë: Neraida, 2001; Arben Puto, *Shqipëria politike*, Tiranë: Toena, 2009; Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, vëll. I (1912-1939), Tiranë: Toena, 2013; Marenglen Verli, *Shqipëria në optikën e diplomacisë austro-hungareze (1877-1918)*, Tiranë: Klean, 2014; Sali Kadria, “Aspekte të gjendjes së nacionalizmit shqiptar gjatë viteve 1916-1918 në zonën e pushtimit austro-hungarez”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2014; Ledia Dushku, “Shqiptarët përballë ushtarakëve dhe diplomatëve austro-hungarezë (1914-1916)”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2016.

<sup>2</sup> Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, përkthyer nga Kujtim Ymeri, Tiranë: Dituria, 2005; Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë – Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*, Tiranë: Pegi, 2012; Kurt Gostentschnigg, *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär: die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918*, Wiesbaden: Springer VS, 2018; Tamara Scheer, *Zwischen Front und Heimat: Österreich-Ungarns Militärverwaltungen im Ersten Weltkrieg*, Frankfurt am Main: Peter Lang, 2009; Tamara Scheer, “Politika okupuese Habsburge ndaj shqiptarëve, myslimanëve dhe turqve në Mal të Zi dhe Serbi gjatë Luftës së Parë Botërore” (Aktet e aktivitetit shkencor *Java e Albanologjisë*, Prishtinë, 15-19 qershor 2015), në *Albanologji* 6, vëll. II, Prishtinë: KGT, 2016.

çështje historike të rolit dhe ndikimit që pati okupimi austro-hungarez te shqiptarët gjatë gjysmës së dytë të periudhës së “Luftës së Madhe”.

### **Qëndrimi i drejtuesve të shtetit austro-hungarez për statusin politik dhe kufijtë e Shqipërisë**

Në fund të vitit 1915, trupat austro-hungarezë thyen ushtrinë serbe, hynë në viset e banuara nga shqiptarët në Kosovë dhe në Malin e Zi dhe vazhduan marshimin e tyre në drejtim të territorit të shtetit shqiptar. Në fillim të hyrjes së trupave austro-hungarezë në Shqipëri, situata ishte në favor të tyre. Krahas gjendjes kaotike brenda vendit dhe pushtimeve të shteteve fqinjë, shqiptarët nuk e harronin faktin se, qeveria e Vjenës qe fuqia kryesore që kishte mbështetur krijimin e shtetit shqiptar në vitet 1912-1913. Për këtë arsye madhore, trupave austro-hungarezë nuk iu bë ndonjë qëndresë e armatosur nga shqiptarët, por siç theksonte profesor Muin Çami, “ato u pritën siç pritet një e keqe më e vogël”<sup>3</sup>. Gjithashtu, mendohej se prania e trupave austro-hungarezë në Shqipëri do të ndikonte pozitivisht për Shqipërinë.

Drejtuesit e shtetit austro-hungarez u përfshinë në diskutimin lidhur me të ardhmen e shtetit shqiptar. Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Perandorisë Habsburge të datës 7 janar 1916, siç njihet tashmë qartë, në mesin e drejtuesve austro-hungarezë u konturuan dy linja qëndrimi ndaj çështjes shqiptare<sup>4</sup>. Diplomacia vjeneze me në krye ministrin e Punëve të Jashtme, Stephan (Iztvan) Burian von Rajecz, i përmbahej qëndrimit se Shqipëria duhej të ruhej si shtet i pavarur ose autonom nën protektoratin austro-hungarez, pasi vetëm nën mbrojtjen e saj do të

<sup>3</sup> Muin Çami, “Hyryra në Shqipëri e pushtuesve austro-hungarezë dhe qëndrimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare”, në *Studime historike*, viti XXX (XIII), nr. 2, Tiranë: 1976, f. 45.

<sup>4</sup> M. Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare...*, f. 224-227; P. Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë ...*, vëll. I, f. 282-286; L. Dushku, “Shqiptarët përballë ushtarakëve dhe diplomatëve austro-hungarezë ...”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2016, f. 75-79; Ledia Dushku, “Aspekte të politikës austro-hungareze ndaj Shqipërisë gjatë Luftës së Madhe (1914-1918)”, në *Shqipëri-Hungari, dje, sot dhe nesër* (Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare organizuar nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër), Shkodër: Fiorentia, 2017, f. 86-88.

krijoheshin kushtet më të mira për zhvillimin e tij. Por, nëse kjo provë dështonte, atëherë duhej të kalohej në planin e ndarjes së Shqipërisë<sup>5</sup>.

Drejtuesit e ushtrisë austro-hungareze ishin kategorikisht kundër krijimit të një shteti të pavarur ose autonom shqiptar nën protektoratin e Austro-Hungarisë. Qëndrimin e tyre, ushtarakët e justifikonin me faktorë të jashtëm<sup>6</sup> dhe të brendshëm<sup>7</sup>. Si zgjidhjen më të mirë të çështjes shqiptare, drejtuesit ushtarakë propozonin që “Shqipëria të vendosej në një okupim të plotë ushtarak që vjen baras me një aneksim” nga ana e Austro-Hungarisë<sup>8</sup>.

Nga muaji shkurt deri në mesin e muajit mars 1916, qarqet diplomatike dhe ushtarake në Vjenë nisën t’i jepnin formë çështjes mbi të ardhmen politike të Shqipërisë, duke arritur në një zgjidhje kompromisi<sup>9</sup>. Fillimisht, drejtuesit e shtetit austro-hungarez vendosën që t’i jepnin zgjidhje problemit të caktimit të një administratori civil, i cili duhej të përmbushte dy kritere kryesore: të ishte njeri i aftë nga pikëpamja profesionale dhe të njihnte mendësinë, zakonet dhe zhvillimet e brendshme politike në Shqipëri. Për këtë qëllim, qysh më 1 shkurt 1916, në mjediset politike u lakua emri i diplomatit August Ritter von Kral, që mbante detyrën e konsullit të Përgjithshëm në Shkodër, si kandidatura më e përshtatshme për t’u caktuar në këtë detyrë<sup>10</sup>.

Nga burimet diplomatike austro-hungareze, lihet për të kuptuar se më 27 shkurt 1916, A. Kral, ishte caktuar zyrtarisht në detyrën e Komisarit civil pranë Korpusit ushtarak XIX me qendër në Shkodër,

<sup>5</sup> *Protokolle des gemeinsamen Ministerrates der Österreichisch – Ungarischen Monarchie (1914-1918)*, Budapest: Akademiai Kiado, 1966, f. 359.

<sup>6</sup> *Haus - Hof und Staats Archiv, Wien Politisches Archiv Albanien* (më tej: *HHSStA, PA, A*), në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 26-17-1727. Udhëzim sekret i gjeneral kolonel baron von Konrad në Kryekomandën e ushtrisë austro-hungareze, drejtuar Komandës së Korparmatës XIX, Teshen, 18 prill 1916.

<sup>7</sup> *Po aty*, Vj. 26-7-724. Kopje e një note rezervate e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze, Teshen, 18 prill 1916.

<sup>8</sup> *Po aty*, Vj. 26-11-1188. Notë sekrete nr. 492 e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze, Teshen, 28 maj 1916.

<sup>9</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Periudha e Pavarësisë (28 nëntor 1912-7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 87.

<sup>10</sup> *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-18-1816. Telegram nr. 107 i kontit Thurn, drejtuar Burian, ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, datë 1 shkurt 1916; Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942* (Kujtime dhe vlerësime historike), botim i dytë, Tiranë: Neraida, 2000, f. 131.

përderisa ai i dërgonte qeverisë austro-hungarezë projektin politik për administrimin e territorit të Shqipërisë së okupuar nga trupat austro-hungareze<sup>11</sup>. Ky projekt synonte në thelb që organizimi i ri administrativ të kishte një “drejtim unik” për të gjithë territorin e Shqipërisë. Ai propozoi ngritjen e një Këshilli të Administratës shqiptare të “instancës së II-të” në Shkodër, që të ishte nën kontrollin e Komandës së lartë austro-hungareze në Shqipëri. Projekti parashikonte ngritjen e një gjykate apeli. Kral mendonte se nga pikëpamja administrative, vendi duhej të ndahej në tri bezirke (rrethe ose distrikte). Në qytetet shqiptare mendohej të ngrihej administrata bashkiake, ndërsa në zonat malore të ruhej organizimi i këshillit të pleqve por nën mbikqyrjen e xhandarmërisë. Gjithashtu, planifikohej që të vendosej shërbimi ushtarak për shqiptarët, që të shërbenin në njësi në formën e milicisë, për një periudhë kohore që zgjaste dy deri në tre muaj<sup>12</sup>.

Autoritetet ushtarake synonin ndërprerjen e situatës kaotike në prapavijat e ushtrisë së tyre si dhe vendosjen e rendit e të stabilitetit politik në Shqipëri. Për vendosjen e rendit dhe qetësisë në Shqipëri, drejtuesit politikë dhe ushtarakë vendosën që të shmangnin fillimisht përdorimin e tepruar të forcës ushtarake ndaj shqiptarëve. Me këtë akt, ata synonin që nga pikëpamja politike dhe ushtarake t’i mbanin shqiptarët në anën e tyre, pasi deklarorin se vinin si “miq të Shqipërisë”<sup>13</sup>. Drejtuesit politikë dhe diplomatët austro-hungarezë, me një përvojë të pasur sa i përket mënyrës së trajtimit të marrëdhënieve të kombeve brenda Perandorisë, dhe që gjithashtu njihnin mirë psikologjinë e shqiptarëve, u mbështetën në traditën e tyre. Në bashkëpunim me parinë, bajraktarët dhe njerëzit me ndikim, fillimisht autoritetet austro-hungareze arritën një “besë” me banorët e zonës së Shkodrës, e cila nënkuptonte dorëzimin e armëve nga shqiptarët. Më tej, komanda austro-hungareze kërkoi që ajo të shtrihej në të gjithë pjesën e okupuar nga trupat e saj<sup>14</sup>.

<sup>11</sup> *Po aty*, Vj. 26-18-1822. Telegram sekret i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 27 shkurt 1916; Kurt Gostentschnigg, “August Ritter von Kral. Aktori kryesor i Austro-Hungarisë në trojet shqiptare”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2016, f. 69.

<sup>12</sup> *Po aty*.

<sup>13</sup> *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. III, f. 85.

<sup>14</sup> *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-9-974. Telegram shifër i A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, datë 25 shkurt 1916.

Më 29 prill 1916, midis shqiptarëve të krahinave të okupuara dhe autoriteteve ushtarake austro-hungareze u shpall një “besë” e përgjithshme<sup>15</sup>.

Akti më miqësor që ndërmoren drejtuesit e shtetit austro-hungarezë ndaj shqiptarëve, krahasuar me fqinjët ishte se Shqipëria u konsiderua, si “vend mik i okupuar” (*Besetztes Freundesland*) në rrethana lufte. Ndërkohë, vendet fqinjë, si Serbia dhe Mali i Zi u vendosën nën regjimin e ashpër ushtarak të trupave austro-hungareze (*K.u.k. Militärverwaltung*). Ndryshe nga vendet fqinje, si Serbia, Mali i Zi dhe pjesa më e madhe e territorit të Rumanisë, në të cilat u vendos Guvernatori i Përgjithshëm Ushtarak austro-hungarez (*Militärgeneralgouvernement*)<sup>16</sup>, qeveria austro-hungareze e trajtoi ndryshe rastin e Shqipërisë. Në mars të vitit 1916, kjo qeveri vendosi pezullimin e përkohshëm të planit për vendosjen e një administrate okupacioni të plotë ushtarak në Shqipëri<sup>17</sup>. Konsulli i Përgjithshëm austro-hungarez, A. Kral u ngarkua me detyrën e Komisarit civil, që të transmetonte orientimet politike të Vjenës, pranë komandës së ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri. Caktimi i një komisar civil në Shqipëri, ngjasonte për nga mënyra e veprimit dhe koha e vendimmarrjes me modelin që u zbatua në Malin e Zi. Pas pushtimit të këtij vendi, ish përfaqësuesi austro-hungarez në Cetinë, Otto Gellinek, u ngarkua me detyrën e Komisarit civil. Por, pas një periudhe të shkurtër kohore, ai u emërua përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë pranë Guvernatoratit të Përgjithshëm Ushtarak në Malin e Zi. Ndryshe nga rasti malazez, ku administrata e pushtimit e këtij vendi, përbëhej nga Departamenti për Çështjet ushtarake dhe Departamenti për Çështjet civile<sup>18</sup>, në territoret shqiptare që ndodheshin nën okupimin austro-hungarez, u ngrit një administratë e përgjithshme

<sup>15</sup> *Po aty*, Vj. 26-15-1535. Raport i A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 26 prill 1916.

<sup>16</sup> T. Scheer, *Zwischen Front und Heimat: Österreich-Ungarns Militärverwaltungen im Ersten Weltkrieg ...*, pp. 38-42, 59; Tamara Scheer, “The perfect opportunity to shape national symbols? Austro-Hungarian occupation regimes during the First World War in the Adriatic and the Balkans”, in *Acta Histriae*, nr. 22(3), January 2014, p. 681.

<sup>17</sup> *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-18-1838. Telegram shifër i Ministrisë së Punëve të Jashtme, drejtuar kontit Thurn, Vjenë, 14 mars 1916.

<sup>18</sup> Vladimir Stojančević, *Srbija i srpski narod za vreme rata i okupacije 1914–1918*, Leskovac: Biblioteka Narodnog muzeja u Leskovcu, 1988, p. 35; Novica Rakočević, *Crna Gora i Austro-Ugarska: 1903-1914*, Titograd: Istorijски institut SR Crne Gore, 1983, pp. 235-236.

civile me qendër në Shkodër, e përbërë nga tri drejtori administrative, të cilat ishin nën autoritetin e Komandës ushtarake të Korpusit XIX të dislokuar në Shqipëri dhe njëkohësisht nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Komisarit civil në këtë vend.

Deri në fillim të muajit mars 1916, autoritetet ushtarake austro-hungareze vendosën nën kontrollin e tyre territorin që shtrihej deri në lumin Shkumbin si dhe kishin nën ndikimin e tyre edhe zonën poshtë këtij kufiri, që shtrihej deri në lumin Vjosa<sup>19</sup>. Pas vendosjes së një pjese të madhe të Shqipërisë nën pushtimin austro-hungarez, u shtrua çështja tjetër se deri ku do të ishte kufiri jugor i Shqipërisë? Qeveria greke i kishte kërkuar asaj austro-hungareze që Greqia të aneksonte të gjithë territorin e Shqipërisë së Jugut deri në lumin Shkumbin. Çështja e kufirit jugor të Shqipërisë u analizua hollësisht nga diplomacia vjeneze. Në lidhje me variantin e propozuar nga Athina, diplomacia austro-hungareze e kishte të qartë se nga njëra anë, propozimet greke ishin të tepruara, nga ana tjetër, shihnin taktikën dinake të diplomatit grek, Skulidhis, i cili “kërkonte më shumë, për të fituar më pak”. Drejtuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, ishin të mendimit se krahinat jugore të Shqipërisë kishin një rëndësi esenciale për vitalitetin politik dhe bazën ekonomike të shtetit shqiptar. Prandaj, qeveria austro-hungareze vendosi që të refuzonte në mënyrë të prerë çdo pretendim të qeverisë greke për të shtrirë kufirin e Greqisë deri në lumin Shkumbin<sup>20</sup>. Austro-Hungaria nuk mund ta pranonte propozimin grek për arsye politike dhe ushtarake. Caktimi i kufirit në lumin Shkumbin, mund të cenonte ndjenjat kombëtare të shqiptarëve. Që të mos krijoheshin dyshime për mundësinë e copëtimit të shtetit shqiptar nga Austro-Hungaria, drejtuesit e këtij shteti vendosën që kufiri jugor i zonës së okupimit të tyre në Shqipëri, të zbriste në territoret në jug të Shkumbinit<sup>21</sup>. Për arsye politike dhe ushtarake, në fund të marsit 1916, Austro-Hungaria pushtoi pjesën më të madhe të vendit, gati dy të tretat e tij. Okupimi austro-hungarez u shtri nga Shkodra e Tropoja në veri deri në vijën që shkon nga derdhja e

<sup>19</sup> Fejzi Alizoti, *Kujtimet e jetës sime politike, 1891-1921*, Tiranë: Deaprint, 2012, f. 104.

<sup>20</sup> *HHSStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-7-734*. Telegram shifër i Ministrisë së Punëve të Jashtme, drejtuar von Szilassy, përfaqësuesit austro-hungarez në Athinë, Vjenë, 24 shkurt 1916.

<sup>21</sup> *Po aty, Vj. 28-6-647*. Deklaratë lidhur me çështjen e vendosjes së një qeverie të përgjithshme ushtarake të Shqipërisë, 12 janar 1918.

Vjosës, Berat, Tomorricë e Pogradec në jug. Në territoret e tjera të shtetit shqiptar në jug të kësaj vije ndodheshin trupat italiane dhe greke<sup>22</sup>.

Gjatë verës së vitit 1916, trupat italianë zgjeruan zonën e pushtimit të tyre nga Vlora në drejtim të viseve të Shqipërisë Jugore dhe Juglindore që mbaheshin të pushtuara më parë nga trupat grekë. Zgjerimi i pushtimit italian në Shqipëri rrezikonte pozitat e Greqisë, e cila ende nuk kishte hyrë në luftë, njëkohësisht edhe interesat e Austro-Hungarisë në këtë vend. Prandaj, në qarqet politike dhe ushtarake vjeneze u shtrua ideja e një lufte të mundshme kundër trupave italianë, për zgjerimin e zonës së okupimit austro-hungarez në jug të Beratit. Mirëpo, me insistimin e qeverisë greke, u vendos që trupat austro-hungarezë të mos e zgjeronin zonën e tyre në jug të Beratit. Në mesin e drejtuesve të qarqeve nacionaliste greke mendohej se vendosja e regjimit austro-hungarez të pushtimit në viset jugore të Shqipërisë, do të krijonte kushte të favorshme për zhvillimin e nacionalizmit shqiptar dhe kjo do t'i hidhte në erë planet e tyre ekspansioniste. Për ato ishte e qartë se Austro-Hungaria ishte dhe mbetej e interesuar për forcimin e nacionalizmit shqiptar në Ballkan. Gjithashtu, drejtuesit e qeverisë greke druheshin se gjatë luftës së trupave austro-hungarezë kundër forcave italiane, do të angazhoheshin formacione ushtarake të përbëra nga shqiptarë. Në këtë mënyrë, mendohej se pas zgjerimit të zonës austro-hungareze në jug të Beratit, do të krijoheshin një mundësi e mirë për zhvillimin e propagandës nacionaliste shqiptare dhe se kjo situatë do të vinte në pikëpyetje aspiratat greke mbi “Epirin e Veriut”, sepse do të vështirësohej veprimtaria e minoritetit grek në Shqipëri<sup>23</sup>.

Çështja e statusit politik të Shqipërisë, u rihap më 9 dhjetor 1916, gjatë një takimi të rëndësishëm që u mbajt në Shtabin e Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze, ndërmjet oficerëve të lartë të kryekomandës ushtarake dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, ku u diskutua mbi të ardhmen e Shqipërisë. Në fund të tij, nuk u arrit në një përfundim të qartë për çështjen e Shqipërisë, pasi përfundimet e mbledhjes ishin një zgjidhje kompromisi mes dy qarqeve austro-hungareze. Drejtuesve të ushtrisë iu kërkua që të hiqnin dorë nga

<sup>22</sup> M. Çami, “Hyrja në Shqipëri e pushtuesve austro-hungarezë...”, në *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1976, f. 45.

<sup>23</sup> *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-11-1132. Telegram shifër tepër sekret i Hornbostel, konsullit austro-hungarez në Janinë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Janinë, 1 shtator 1916.

mendimi kundër politikës proshqiptare të diplomacisë vjeneze. Drejtuesit ushtarakë këmbëngulën në kërkesën se, qeveria austro-hungareze duhej t'i deklaronte popullit shqiptar se ajo ishte vetëm “për një autonomi [të tij] në të ardhmen”<sup>24</sup>. Kjo mbledhje përgatiti në vija të përgjithshme përmbajtjen e proklamatës së datës 23 janar 1917, ku u shpall “autonomia” e Shqipërisë nën protektoratin e Austro-Hungarisë, çështje e cila është trajtuar gjerësisht<sup>25</sup>.

Kërkesat e ekzagjeruara bullgare ndaj territorit të Shqipërisë që u artikuluuan në fillim të janarit 1918, nxitën Komisararin civil, A. Kral, t'i kërkonte Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë se për Shqipërinë, ishte momenti i duhur që “të zbatohet parimi i vetvendosjes së kombeve...sidomos përsa i përket bashkimit të territoreve verilindore, lindore dhe në jug të Shqipërisë”<sup>26</sup>. Drejtuesit e qarqeve ushtarake dolën kundër mendimit të diplomacisë austriake me argumentin se qeveria bullgare kishte aspirata të qarta ndaj Shqipërisë<sup>27</sup>. Pavarësisht qëndrimit të ushtarakëve, në vjeshtën e vitit 1918, qeveria austro-hungareze lëshoi disa direktiva për autoritetet e saj lidhur me politikën që do të ndiqej në Shqipëri. Kjo platformë politike synonte në thelb që “populli shqiptar duhej të shikohet dhe të trajtohet si një komb neutral pro austriak”<sup>28</sup>. Mirëpo, ky kurs i ri politik u mjaftua me këtë qëndrim dhe nuk arriti deri aty sa qeveria austro-hungareze të rikonfirmonte Pavarësinë e Shqipërisë.

Prania austro-hungareze në Shqipëri, në vitet 1916-1918, paraqet interes të veçantë, nëse shqyrtohet në këndvështrimin se si ndikoi ajo në

<sup>24</sup> *Po aty*, Vj. 26-18-1838, Vj. 26-12-1216. Raport i A. Rappaport, drejtuar A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Vjenë, 15 dhjetor 1916; L. Dushku, “Aspekte të politikës austro-hungareze ndaj Shqipërisë ...”, në *Shqipëri-Hungari, dje, sot dhe nesër...*, f. 89.

<sup>25</sup> *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 27-8-819. Teksti i proklamatës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, drejtuar A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Vjenë, 21 janar 1917; M. Verli, *Shqipëria në optikën e diplomacisë austro-hungareze...*, f. 350-351; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2017, f. 388.

<sup>26</sup> *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 28-4-435 dhe Vj. 28-6-633. Telegram shifër i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 18 janar 1918.

<sup>27</sup> *Po aty*, Vj. 28-5-523. Shkresë nr. 1691/rez. i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze, drejtuar kontit Burian, 21 korrik 1918.

<sup>28</sup> *Po aty*, Vj. 28-2-232. Shtojca e shkresës nr. 4340, Amendamenti “Direktivat politike për administratën e Shqipërisë”, data 14 shtator 1918.

të ardhmen e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Trajtimi i këtij problemi kompleks, kërkon studime të mëtejshme, si dhe një shqyrtim të kujdesshëm dhe objektiv të fakteve historike. Nga zhvillimet që ndodhën gjatë dy viteve të fundit të “Luftës së Madhe”, duket se vendosja e një lloj dominimi nga ana e qarqeve ushtarake, nuk ishte në favor të shqiptarëve, për shkak të qëndrimit të ftohtë që mbanin drejtuesit ushtarakë ndaj tyre. Me këmbënguljen e këtyre qarqeve u vendos që në Shqipëri “të evitohet krijimi i një mekanizmi administrativ të shtrenjtë e të komplikuar”, i cili i kalonte nevojat e vendit dhe që kërkonte më vonë sakrificat të mëdha për ta mbajtur në këmbë<sup>29</sup>.

Në vështrim afatgjatë të kësaj çështjeje, dominimi i rretheve ushtarake mbi ato diplomatike cenonte interesat kombëtarë të shqiptarëve. Kjo për faktin se diplomatët austro-hungarezë, jo vetëm që i njihnin shqiptarët dhe popujt e tjerë të rajonit të Ballkanit më mirë se ushtarakët, por që nga vitet '70 të shek. XIX e në vazhdim, një pjesë e mirë e tyre u treguan aktivë ndaj zhvillimeve politike të çështjes kombëtare shqiptare. Për më tepër, cenimi i statusit të Pavarësisë së Shqipërisë, me këmbënguljen e qarqeve ushtarake austro-hungareze, rrezikonte të ardhmen e shtetit shqiptar dhe ekzistencën kombëtare të shqiptarëve. Duke parashikuar me qartësi dhe largpamësi, mundësinë e këtij rreziku, drejtuesit e Federatës Panshqiptare “Vatra”, shpreheshin në mënyrë të sintetizuar se, “shkelia është shkelie prej cilitdo që të bëhet dhe për neve nuk ka nonjë ndryshim...”<sup>30</sup>. Syrja Bej Vlora, sqaronte se, administrimi ushtarak i Austro-Hungarisë në Shqipëri ishte në favor të Monarkisë. Ai synonte të realizonte njëherësh dy objektiva kryesorë: vendosjen e stabilitetit politik brenda vendit që të fitonte simpatinë e shqiptarëve dhe të mos cenonte ndjenjat dhe interesat e popujve sllavë që ndodheshin brenda kësaj perandorie<sup>31</sup>.

Megjithëse hapësira e një artikulli shkencor, nuk lejon trajtesa të gjata, duhet theksuar se, prezenca austro-hungareze në këto vite në Shqipëri kërkon një analizë të kujdesshme. Gjatë kësaj periudhe Shqipëria pësoi humbje të rënda nga Lufta e Parë Botërore, si vrasja e një

<sup>29</sup> *Po aty*, Vj. 26-18-1838. Telegram shifër i Ministrisë së Punëve të Jashtme, drejtuar kontit Thurn, Vjenë, 14 mars 1916.

<sup>30</sup> *Dielli*, nr. 517, Boston Mass., datë 16 nëntor 1915, f. 2.

<sup>31</sup> Syrja Vlora, *Kujtime – Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, përgatitur për botim dhe redaktuar nga Marenglen Verli dhe Ledia Dushku, Tiranë: Iceberg, 2013, f. 163.

numri shqiptarësh gjatë ekspeditave të ushtrisë austro-hungareze në Lurë dhe në krahina të tjera, ekzekutimi i disa oficerëve shqiptarë në vijën e frontit pranë lumit Vjosa dhe vdekje të shumta për shkak të krizës së thellë të urisë. Mirëpo, prania e saj pati edhe ndikim pozitiv në disa fusha të jetës së shqiptarëve, ndër të cilat mund të përmenden: vendosja e një administrate efikase, ngritja e një sistemi arsimor dhe kulturor kombëtar, e cila u reflektua në ngritjen e shkollave shqipe, botimet e librave, gazetave dhe të hartave në gjuhën shqipe, dërgimin e dhjetëra studentëve shqiptarë për studime në universitetet austriake, ngritjen e Komsisë Letrare, e cila hodhi piketat e gjuhës standarde shqipe, ndërtimin e rrugëve, urave, të rrjetit të dekovilëve dhe zyrave postë-telegrafike, realizimin e numërimit të popullsisë. Zhvillime pozitive pati edhe në sektorët e ekonomisë, të financave, të tregtisë dhe të shëndetësisë. Të gjitha këto arritje gjatë viteve 1916-1918, studiuesi P. Milo i konsideron si “vetëadministrim të shqiptarëve nën protektoratin austro-hungarez”<sup>32</sup>. Fitorja më e madhe ishte se shqiptarët shpëtuan nga shfarosja dhe persekutimi i egër sllav dhe forcuan identitetin e tyre kombëtar.

### **Modeli i administratës shqiptare të ngritur nën drejtimin dhe me mbështetjen e autoriteteve politike e ushtarake austro-hungareze**

Në fillim të muajit prill 1916, pas miratimit nga qeveria austro-hungareze, territori i Shqipërisë iu nënshtrua një organizimi të ri administrativ, i cili ndryshe nga propozimi i konsullit Kral, parashikohej që vendi të ndahej jo në tre, por në katër distrikte (rrethe): Shkodra, Puka, Kruja dhe Tirana. Këto njësi administrative u vendosën nën komandën e ushtrisë austro-hungareze<sup>33</sup>. Me kalimin e kohës, organizimi administrativ i vendit u rikonfigurua dhe u nda më tej në njësi më të vogla, në qarqe dhe komuna. Rrethi (distrikti) i Shkodrës përfshinte katër qarqe; rrethi Pukë kishte dy qarqe; rrethi i Zhurit përfshinte pesë qarqe; rrethi i Krujës përbëhej nga dy qarqe; rrethi i Tiranës kishte shtatë qarqe, dhe rrethi i Beratit përfshinte pesë qarqe<sup>34</sup>.

<sup>32</sup> P. Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë ...*, vëll. I, f. 281.

<sup>33</sup> *HHSIA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-18-1864. Shpallja nr. 25/Pol., mbi vendosjen e autoriteteve ushtarake austro-hungareze në Shqipëri, Shkodër, 28 mars 1916.

<sup>34</sup> *Po aty*, Vj. 28-6-659. Raporti i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 24 maj 1918.

Synimi i A. Kral ishte që institucioni i Komisarariatit civil në Shqipëri, të kthehej në një organ të pavarur nga administrata ushtarake e vendit<sup>35</sup>. Në vijim të përpjekjeve për forcimin e institucionit të Komisarit civil, veçanërisht pas konsolidimit të pozitës së trupave austro-hungarezë në Shqipëri, autoritetet austriake vendosën t'i jepnin një goditje përfundimtare administratës shqiptare të drejtuar nga Aqif Pashë Elbasani si dhe të gjitha lëshimeve sado të vogla të karakterit politik, që u ishin bërë shqiptarëve deri në këtë periudhë, të imponuara nga rrethanat e luftës. Qeveria austro-hungareze u shpreh se as “që mund të bahet fjalë për njohjen e Aqif Pashës si ministër dhe të funksionarëve të emnuem prej tij dhe të mbajtur përkohësisht prej administratës sonë ushtarake”<sup>36</sup>. Në mbështetje të qëndrimit të qeverisë austro-hungareze, A. Kral, i raportonte Vjenës se kishte ndërmend të emëronte nëpunës të tjerë shqiptarë në krahinat, në të cilat nuk funksiononte administrata deri në këtë periudhë, si dhe në ato vende ku kishte të tillë. Qëllimi i tij ishte që të merrte nën kontroll administratën vendore në rajonin e Shqipërisë së Mesme, ku pak më herët, Aqif Pashë Elbasani në vijim të përpjekjeve të grupit nacionalist shqiptar, për formimin e një qeverie kombëtare, kishte emëruar një numër nëpunësish në administratën vendore. Gjithashtu, synimi i tij ishte që të bëhej një “shoshitje e personelit ekzistues”, për të zgjedhur nëpunësit më të mirë. Madje, ai i kërkonte mendim drejtuesve të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë se si duhej të vepronte kundrejt forcave të xhandarmërisë shqiptare, të cilat mbanin ende në uniformat e tyre simbole kombëtare shqiptare të periudhës së qeverisjes së Ismail Qemalit dhe të Princ Vedit<sup>37</sup>. Pavarësisht këtij qëndrimi, A. Kral vendosi që një pjesë e drejtuesve dhe e nëpunësve të mëparshëm të administratës vendore në krahinat malore, të qëndronin në detyrat që mbanin deri në këtë periudhë. Në këtë rast, autoritetet e administratës ushtarake ndoqën parimin “mos me ba shumë reforma...sepse populli asht mësuar me atë

<sup>35</sup> *Po aty*, Vj. 26-11-1193. Telegram i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 25 shtator 1916.

<sup>36</sup> *Po aty*, Vj. 26-6-618. Telegram shifër e Ministrisë së Punëve të Jashtme, drejtuar A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Vjenë, 23 mars 1916.

<sup>37</sup> *Po aty*, Vj. 26-6-615. Telegram i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 6 prill 1916.

[model]”, por edhe për faktin se në këto krahina mungonin njerëzit e përshtatshëm për drejtim<sup>38</sup>.

Pas fillimit të punës për riorganizimin administrativ të vendit, Komisari civil A. Kral vendosi që të shpërbënte administratën kombëtare të emëruar nga Aqif Pasha, që shtrihej në zonën e Shqipërisë së Mesme deri në Berat, mbështetur në dy argumente kryesore: *së pari*, pranimi i kësaj administrate që shtrihej në një pjesë të kufizuar të Shqipërisë, krijonte një trajtim të pabarabartë ndërmjet krahinave të ndryshme të vendit; *së dyti*, ekzistenca e një qeverie shqiptare, konsiderohej e papranueshme edhe në aspektin ndërkombëtar. A. Kral shprehej se prania e qeverisë shqiptare krijonte përshtypjen te kancelaritë evropiane, se Austro-Hungaria ishte duke shkelur vendimet ndërkombëtare të Konferencës së Londrës të vitit 1913, pasi me nismën e ish ministrit të Princit filogjerman W. von Wied, kishte formuar një qeveri shqiptare në Elbasan. Konsulli i Përgjithshëm, Kral, nguli këmbë që për arsye politike dhe për të shmangur keqkuptimet që mund të lindnin brenda dhe jashtë vendit, administrata në Shqipëri duhej të ishte unike<sup>39</sup>.

Në të vërtetë, më tepër se për motive të jashtme, qarqet politike dhe ushtarake vjeneze nuk lejonin ekzistencën e një qeverie shqiptare, për shkak të përplasjes mes diplomacisë dhe ushtrisë, por edhe për arsyet e politikës së tyre të brendshme nacionale. Nëse Austro-Hungaria lejonte ekzistencën e qeverisë shqiptare, ajo krijonte një precedent politik, i cili mund të ngjallte reaksionin e kombeve të tjerë që gjendeshin brenda apo ish-in pushtuar nga Monarkia Habsburge. Në këndvështrimin e drejtuesve të qeverisë së Vjenës, në vend të formimit të një qeverie shqiptare, dëshirohej që autoritetet ushtarake në Shqipëri të tërhiqnin sa më tepër elementë të shquar shqiptarë në këtë administratë. Por, ata porosisnin që të bëhej kujdes për “të hequr çdo dyshim se në ato pjesë të Shqipërisë të okupueme prej nesh, përveç komandave perandorake e mbretërore ekzistonte ndonjë burim tjetër i pushtetit qeveritar dhe se çdo funksionar

<sup>38</sup> *Po aty*, Vj. 26-11-1200. Raport i Komandës së Korpusit të ushtrisë, nënshkruar nga Feldmareshalli I. Trollman, datë 9 shtator 1916.

<sup>39</sup> *Po aty*, Vj. 27-6-623. Telegram shifër tepër rezervat i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 30 shtator 1917.

vendas mandatin e tij e merr vetëm prej administratës sonë ushtarake dhe jo nga një anë tjetër”<sup>40</sup>.

Drejtnesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme udhëzonin se nga pikëpamja ushtarake dhe politike, zyrat ushtarake dhe të zbulimit në Shqipëri duhet “t’u bajnë favore notabelve të vendit dhe t’i fitojnë për çështjen tonë”, por të mbahej parasysh që përpjekjet për afrim, të mos krijonin mendimin në popull dhe te paria shqiptare se “komandat tona dhe autoritetet lokale shqiptare janë faktorë që ekzistojnë njani pranë tjetrit, pothuajse me të drejta të barabarta”<sup>41</sup>. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze, F. Conrad von Hötzendorf doli kundër diplomacisë vjeneze, lidhur me qëndrimin që duhej mbajtur ndaj parisë shqiptare. Ai mendonte se shtresës së njerëzve me ndikim në Shqipëri, si fisnikë dhe bajraktarë duhej t’i jepej një goditje e fortë, pasi ajo ishte shkaktarja e situatës së vështirë në këtë vend. Në këndvështrimin e tij, paria shqiptare e përbërë nga njerëz të tillë, si Preng Bibë Doda, Irfan bej Ohri, Basri Beu e të tjerë, “nuk ishin aspak më të mirë se Esat Pashë Toptani, i cili doli hapur kundër nesh”. Sipas tij, këta njerëz ndikonin te grupet mbështetëse të tyre “në favor të atij që paguan ma shumë ose që asht ma i fortë, me qëllim që të marrin pjesë në plaçkën e tij”<sup>42</sup>.

Më 23 prill 1916, komandanti austro-hungarez I. Trollman nxori një urdhër, i cili përcaktonte mënyrën e sjelljes së nëpunësve shqiptarë të administratës vendore gjatë shërbimit zyrtar<sup>43</sup>. Në këtë urdhër, parashikohej qartë kategoria e personave që mund të merrnin funksione administrative, mënyra e emërimit të tyre, detyrimet dhe të drejtat e nëpunësve si dhe masat administrative për rastet e shkeljeve së normave gjatë ushtrimit të detyrës. Administrata civile shqiptare urdhëroi nëpunësit vendorë që të gjitha raportet e tyre zyrtare t’i hartonin në gjuhën shqipe ose atë gjermane dhe t’ia dërgonin Drejtorisë së

<sup>40</sup> *Po aty*, Vj. 26-6-617. Telegram shifër i Ministrisë së Punëve të Jashtme, drejtuar Kral, konsullit të Përgjithshëm në Shkodër, Vjenë, 26 mars 1916.

<sup>41</sup> *Po aty*.

<sup>42</sup> *Po aty*, Vj. 26-11-1188. Notë sekrete nr. 492 e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze, Teschen, 28 maj 1916.

<sup>43</sup> Lef Nosi, *Dokumenta historike për t’i shërbye historiës tonë kombëtare*, botim i dytë, përgatitja për botim dhe redaktimi shkencor nga Marenglen Verli dhe Ferit Duka. Parashkresë mbi përmbajtjen e sjelljen në shërbim të zyrtarvet, nenzyrtarvet e shërbitorvet shqiptarë, Shkodrë, 23 prill 1917, Tiranë: Nënë Tereza, 2007, f. 259-264.

Përgjithshme të administratës shqiptare<sup>44</sup>. Gjatë periudhës 1916-1918, u arrit që administrata shqiptare në zonën e okupuar nga forcat austro-hungareze, të krijonte një model të standardizuar mbi mënyrën e formulimit dhe të paraqitjes së shkresave zyrtare. Njëkohësisht, autoritetet austro-hungareze i caktuan si detyrim administratës shqiptare, afatin maksimal kohor, brenda të cilit një shkresë zyrtare duhej të dërgohej nga zyrat vendore të distrikteve në Drejtorinë e Përgjithshme në Shkodër si dhe nga një zyrë e një distrikti në tjetrin<sup>45</sup>. Kjo masë ndikonte në kufizimin e burokracisë zyrtare dhe në krijimin e një administrate të përgjegjshme dhe efikase.

Në këto rrethana, njësoj si më parë, drejtuesit e qeverisë vjeneze dhe nacionalistët shqiptarë u përpoqën të harmonizonin interesat e tyre politike me interesat kombëtare të shqiptarëve<sup>46</sup>. Autoritetet austro-hungareze ishin plotësisht të interesuara për vendosjen e një administrate efikase shqiptare, pasi prishja e rendit dhe e qetësisë brenda vendit, do të ndikonte negativisht në faktin që Austro-Hungaria do të humbiste rëndësinë para popullit shqiptar e më gjerë. Gjithashtu, mungesa e administratës dhe e rendit e qetësisë, ishte një motiv që mund të nxiste popullsinë shqiptare që të ngrihej kundër forcave austro-hungareze<sup>47</sup>. Për këtë arsye, komanda e ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri, vendosi një sistem të centralizuar të administratës në territorin ku ushtronte kontrollin e saj. Rregulli brenda administratës vendore shqiptare arriti deri në atë nivel, sa ajo filloi të mbante dosje të rregullta për nëpunësit, të cilat përmbanin të dhëna të sakta për secilin prej tyre. Nëpunësit që kërkonin të punësoheshin, ishin të detyruar të paraqisnin me shkrim të dhëna të sakta mbi vendlindjen, vitin e lindjes, arsimin që kishin kryer, gjuhët që flisnin dhe shkruanin, detyrat që kishin mbajtur më parë, si dhe në dosjet e administratës mbaheshin shënime të rregullta lidhur me vërejtjet e

<sup>44</sup> *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-20-2012. Shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për Kral, konsullin austro-hungarez në Shkodër, Vjenë, 8 prill 1916.

<sup>45</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 235, Viti (më tej: V.) 1916, Dosja (më tej: D.) 11, fl. 1. Shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Financave, drejtuar Zyrës së Financave Krujë, Shkodër, më 1 gusht 1916.

<sup>46</sup> Fehari Ramadani, "Shqipëria në politikën e Austro-Hungarisë në fillim të shek. XX", në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2008, f. 63.

<sup>47</sup> *AQSH*, F. 271, V. 1917, D. 3, fl. 23. Shkresë e nënprefektit të Elbasanit, Dervish Hima, drejtuar Drejtorisë së Dumresë në Belsh, Elbasan, 2 shtator 1917.

mëparshme gjatë punës së nëpunësve<sup>48</sup>. Kjo praktikë pune pati ndikim pozitiv tek administrata shqiptare, pasi jo vetëm që u krijua një procedurë e rregullt e emërimeve të zyrtarëve, por nëpunësit filluan që të ruanin me kujdes dokumentacionin e tyre personal si dhe shkresat zyrtare<sup>49</sup>. Krahas nxitjes së krijimit të elementëve të një burokracie zyrtare dhe kërkesës për korrektësi në zbatimin e detyrave nga ana e nëpunësve shqiptarë, në disa raste, komanda e Korparmatës XIX u përpoq që të merrte masa edhe për përmirësimin e gjendjes ekonomike të nëpunësve shqiptarë, sidomos për të zbutur efektet negative të krizës ekonomike që u krijua për shkak të zhvlerësimit të monedhës austro-hungareze<sup>50</sup>.

Zbatimi i modelit perëndimor nga administrata vendore që gjendej nën kontrollin austro-hungarez, i ndihmoi shqiptarët në përpjekjet e tyre për rindërtimin e shtetit kombëtar në vitet e mëvonshme. Eqrem Bej Vlora ka shprehur mendimin se nëse pas vitit 1920, u krijua një shtet shqiptar pak a shumë i rregullt dhe u formua një ndërgjegje e përbashkët kombëtare, kjo u arrit edhe për shkak të ndikimit pozitiv që ushtroi Austro-Hungaria në Shqipëri, gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore. Pa ndikimin e mirëfilltë kombëtar të kësaj administrate, kishte të ngjarë që shqiptarët edhe pas luftës, të kishin vazhduar shërbimet e tyre të klientelës dhe të pranonin pozitën e varësisë ndaj shteteve të huaja<sup>51</sup>. Përvoja e viteve 1912-1916, dëshmoi se shqiptarët ndeshën probleme të mëdha në lidhje me ngritjen e një strukture efikase shtetërore. Nga kjo periudhë, një pjesë e elitës intelektuale në vend filloi të kuptonte se bashkimi kombëtar nuk mund të bëhej vetëm përmes shtypit, por ai arrihej më shpejt dhe më mirë nëse në Shqipëri vendosej një administratë unike dhe e centralizuar, e cila garantonte jetën, nderin dhe pasurinë e shqiptarëve. Për arritjen e këtij qëllimi, Gjergj Fishta shprehej se shqiptarët duhej të mësoheshin që për hir të unitetit kombëtar, të pëlqenin

<sup>48</sup> *Po aty*, F. 271, V. 1917, D. 2, fl. 6. Lista e nëpunësve të Katundaries së Elbasanit, Elbasan, 5 janar 1917.

<sup>49</sup> *Po aty*, F. 271, V. 1917, D. 3, fl. 2. Letër e nënprefektit të Elbasanit, Dervish Hima, drejtuar Drejtorisë së Dumresë në Belsh, 20 gusht 1917.

<sup>50</sup> *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 28-3-388. Raport i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 4 mars 1918.

<sup>51</sup> Eqrem bej Vlora, *Kujtime (1885-1925)*, përkthyer nga Afrim Koçi, Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2003, f. 434.

një mënyrë të menduari dhe të vepruari, për të bashkuar rreth saj interesat individuale të të gjithëve<sup>52</sup>.

Në fillim të okupimit austro-hungarez të Shqipërisë, popullsia shqiptare pati shpresa të mëdha te regjimi austriak<sup>53</sup>. Pas aneksimit të një pjese të madhe të trojeve etnike shqiptare në vitin 1913, dy viteve të vështira nën sundimin e egër të Serbisë dhe Malit të Zi dhe zgjerimit të aneksimeve nga Beogradi dhe Cetina gjatë vitit 1915, në kurriz të trojeve të tjera të shtetit shqiptar<sup>54</sup>, për shqiptarët ishte një lloj lehtësimi kur shihnin fitoret e ushtrisë austriake ndaj fqinjëve sllavë. Përkundrazi, një qëndrim i kundërt ndaj pranisë austro-hungareze, do të ishte një vetëvrasje politike për shqiptarët. Pas okupimit të territoreve të banuara të tyre nga një fuqi mike, shqiptarët prisnin që të përmirësohej gjendja politike dhe ekonomike e tyre. Ndryshe nga modelet e mëparshme të qeverisjes së shteteve ballkanike, popullsia shqiptare shpresonte vendosjen e një modeli krejt tjetër nga Austro-Hungaria si një fuqi e madhe në fushën politike dhe ekonomike. Mirëpo, nuk kaloi shumë kohë kur këto shpresa filluan të zbehen te një pjesë e madhe e shqiptarëve. Në këtë drejtim ndikoi mënyra se si u zhvillua nga autoritetet austro-hungareze, procesi i çarmatosjes së popullsisë, i rekuizimeve të kafshëve të ngarkesës dhe rekrutimi i detyrueshëm ushtarak, të cilat krijuan një përshtypje të keqe te popullsia shqiptare<sup>55</sup>.

Administrata austro-hungareze filloi të cilësohej jo vetëm si “e keqe”, por u përhap mendimi se “ajo ishte edhe më e keqe se ajo e Turqisë”. Për rrjedhojë, që nga gjysma e dytë e vitit 1916, autoriteti i administratës shqiptare në vend kishte rënë në minimum dhe ajo konsiderohej si një “instancë ndërmjetëse që funksionon keq”. Ndër kritikën kryesore që shqiptarët kishin ndaj administratës austro-hungareze ishin: *së pari*, ata mendonin se administrata ishte tepër e centralizuar, pasi për zgjidhjen e një problemi të vogël të banorëve, nëpunësit e zyrave

<sup>52</sup> Gj. Fishta, “Kurr do t’bashkohen Shqiptarët”, në *Posta e Shqipërisë*, nr. 17, Shkodër, 3 shkurt 1917, f. 1-2.

<sup>53</sup> *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 27-9-934. Raport i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 2 dhjetor 1917.

<sup>54</sup> M. Çami, “Hyrja në Shqipëri e pushtuesve austro-hungarezë...”, në *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1976, f. 46.

<sup>55</sup> *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-19-1921. Referat nr. 75 mbi gjendjen në Shqipërinë e Mesme i Zyrës së Komandës Imp. dhe Mbret. në Elbasan, Elbasan, 3 qershor 1916; Ledia Dushku, “Shqiptarët përballë ushtarakëve dhe diplomatëve austro-hungarezë (1914-1916)”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2016, f. 80-84.

vendore duhej të merrnin udhëzime nga qendra administrative në Shkodër, ndërkohë që administratat e tjera vendore nuk ishin kompetente. Në këtë mënyrë, zbehej autoriteti i administratës lokale, pasi ajo nuk mund t'u jepte banorëve një përgjigje të shpejtë për asnjë çështje; *së dyti*, një pjesë e popullsisë ankohej për nivelin e lartë të korrupsionit të nëpunësve vendas; *së treti*, administrata nën kontrollin austro-hungarez, cilësohej si tepër burokratike dhe jo praktike; *së katërti*, për shkak të gjendjes së luftës, ekzistonte një lloj shkëputjeje midis administratave lokale me njëra-tjetrën; *së pesti*, në mesin e shqiptarëve kishte pakënaqësi lidhur me faktin se ndërmjet bezirkeve (distrikteve) administrative të vendit, nuk kishte një trajtim të barabartë sa i përket mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave si dhe pagave të nëpunësve; *së gjashti*, për shkak të trazirave që kishin ndodhur më herët në Shqipëri, kjo popullsi kishte pritur vendosjen e një autoriteti të fortë qeverisës, i cili do të mund të merrte në mbrojtje çdo banor të vendit<sup>56</sup>.

### **Gjendja ekonomike dhe financiare e territorit të Shqipërisë që gjendej nën okupimin austro-hungarez**

Sipas këndvështrimit të drejtuesve të Komandës së Korparmatës XIX në Shqipëri, mjeti më i mirë që mund të forconte ndikimin austriak në Shqipëri si dhe rolin e shqiptarëve në Ballkan ishte përmirësimi i gjendjes ekonomike të popullsisë shqiptare dhe i mënyrës së administrimit të vendit. Në ndikimin e rrethanave të luftës por edhe për shkak të mendësisë perandorake, ata mendonin se strategjia më e mirë që mund të lehtësonte hyrjen e ideve të reja, zhvillimin e ekonomisë së Shqipërisë dhe modernizimin e jetës shoqërore të vendit ishte që kompanitë dhe qeveria austro-hungareze të blinin produktet bujqësore dhe blegtorale të shqiptarëve dhe të shfrytëzonin lëndët e para të Shqipërisë për industrinë austriake, si dhe kompanitë austro-hungareze të mund të realizonin investime të rëndësishme në ekonominë shqiptare, ndërsa bankat austro-hungareze të investonin kapitalet e tyre, për krijimin e një banke në Shqipëri si dhe ato të orientoheshin në blerjen e pasurive

<sup>56</sup> *HHS*A, PA, A, në *AIH*, Vj. 26-19-1921. Referat nr. 75, hartuar nga Zyra e komandës Imp. dhe Mbret. në Elbasan, mbi gjendjen në Shqipërinë e Mesme, Elbasan, 3 qershor 1916.

të patundshme të këtij vendi<sup>57</sup>. Natyrisht, që këto objektiva ishin demagogjikë, por ato nuk u realizuan edhe për shkak të gjendjes së luftës si dhe periudhës së shkurtër të pranisë austro-hungareze në Shqipëri. Megjithatë, mbështetur në këtë orientim politik, gjatë vitit 1916, filloi të rritej niveli i shkëmbimeve tregtare të shqiptarëve me Austro-Hungarinë. Nga bilanci i shkëmbimeve, vihej re se shqiptarët kishin nevojë për mallra industriale austro-hungareze, ndërkohë që ushtria e këtij vendi rriti nivelin e blerjeve sa më tepër që ndihej mungesa e produkteve bujqësore dhe blegtorale në Monarkinë Habsburge<sup>58</sup>.

Akti i parë i komandës austro-hungareze për ngritjen e administratës civile ishte urdhri i saj për emërimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Financave të Shqipërisë. Fejzi Alizoti u emërua drejtor i Përgjithshëm i Financave<sup>59</sup>. Në fillim të gushtit 1916, Drejtoria e Përgjithshme e Financave në Shkodër, vendosi të kompensonte shqiptarët që ishin dëmtuar nga veprimtaria e qeverisë së drejtuar nga Esad Pashë Toptani, duke vënë në dizpozicion të tyre pasuritë e këtij të fundit që kishte në Shqipëri<sup>60</sup>. Ky akt synonte që të dëmtonte bazën mbështetëse ekonomike të Esad Pashës dhe të mbështetësve të tij në Shqipëri, si dhe të nxiste shqiptarët që të lidheshin më shumë me autoritetet ushtarake austro-hungareze. Gjithashtu, administrata financiare që u ngrit, përpunoi një sistem të rregullt të dhënash për nëpunësit e administratës vendore shqiptare që gjendej nën okupimin austro-hungarez. Ajo kishte për qëllim që të vendosej saktësi në raportin midis masës së pagave dhe vëllimit të punës së kryer nga nëpunësit<sup>61</sup>.

Pas pushtimit të Shqipërisë nga trupat austro-hungarezë, Monarkia Dualiste vendosi që të ruante Zyrën e Borxhit Publik Osman, me qendër në Lushnjë dhe në Berat. Kjo masë u kushtëzua nga dy faktorë; *së pari*, lidhej me interesin e Austro-Hungarisë për ruajtjen e kësaj zyre, e cila

<sup>57</sup> *Po aty*, Vj. 26-7-755. Raport sekret i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, e cila përmbante propozimet ekonomike që Komanda e Korparmatës XIX i drejtonte Kryekomandës së Ushtrisë, Shkodër, 2 maj 1916.

<sup>58</sup> *Po aty*, Vj. 26-18-1805. Relacion politik dhe administrativ i Komandës së Korparmatës XIX, Shkodër, 16 tetor 1916.

<sup>59</sup> F. Alizoti, *Kujtimet e jetës sime...*, f. 106.

<sup>60</sup> *AQSH*, F. 235, V. 1916, D. 24, fl. 8. Shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Financave, drejtuar Zyrës së Financave në Krujë, Shkodër, më 9 gusht 1916.

<sup>61</sup> *Po aty*, F. 235, V. 1916, D. 3, fl. 1. Shkresë e Gjykatës Paqtuese Krujë, drejtuar drejtorit të Financës, Krujë, 19 shtator 1916.

ishite pjesë e sistemit të kapitulacioneve të Perandorisë Osmane; *së dyti*, gjatë periudhës së “Luftës së Madhe”, Austro-Hungaria ishte në aleancë me Perandorinë Osmane dhe prania e zyrës ndikonte në mbledhjen e të ardhurave që shkonin në buxhetin e shtetit osman. Gjatë viteve 1916-1918, me anë të kësaj zyre të posaçme u administrua pasuria publike në Shqipëri, e cila mblidhte një të tretën e prodhimeve bujqësore nga bujqit e shtetit dhe u jepte atyre si ndihmë farëra dhe mjete të tjera bujqësore<sup>62</sup>.

Deri në fillim të vitit 1916, shumica e banorëve të Shqipërisë mund të konsiderohen si “të privilegjuar”, për sa i përket pagimit të taksave e tatimeve. Me përjashtim të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut, ku ekzistonin disa zyra tatimesh, të cilat funksiononin në mënyrë jo të kënaqshme, pjesa tjetër e popullsisë së vendit nuk paguante ose përpiqej t’i shmangej detyrimeve ndaj shtetit. Taksat dhe tatimet paguheshin kryesisht nga banorët e zonave fushore të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut, ndërsa në Shqipërinë e Veriut paguanin vetëm banorët e krahinës së Zadrimës. Një veçori tjetër e mënyrës së funksionimit të sistemit tatimor në Shqipëri ishte fakti se deri në këtë periudhë asnjë nga tatimet, si të dhjetat dhe xhelepi nuk mblidheshin në mënyrë të njëjtë në të gjithë vendin<sup>63</sup>.

Situata në sistemin e taksave dhe të tatimeve pësoi një ndryshim të rëndësishëm pas okupimit austro-hungarez të Shqipërisë në vitin 1916. Nga ky vit e në vazhdim u krijua një strukturë e re financiare e përbërë nga nëpunës shqiptarë, të cilët njohën dhe zbatuan praktikat moderne të administrimit financiar. Një ndër vështirësitë e para në punën e kësaj administrate ishte vazhdimi i përdorimit të gjuhës turke nga nëpunësit që ishin në detyrë që nga periudha e regjimit osman. Për këtë arsye, autoritetet ushtarake austro-hungareze vendosën të detyronin nëpunësit e sistemit tatimor që të mësonin gjuhën shqipe ose të largoheshin nga puna si dhe të zëvendësohej gjuha osmane me gjuhën shqipe në dokumentacionin tatimor. Korrespondenca me komandën austro-hungareze në Shkodër bëhej në gjuhën shqipe, ndërkohë që vetëm raportet përktheheshin në gjuhën gjermane. Veprimi i parë i Fejzi Alizotit dhe Mexhit Naraçit ishte përkthimi i modelit të letër adjukatës [mezadkaimet] (letër në të cilën një organ ose person zyrtar i përcakton detyrimet një organi ose personi tjetër) për aktet e shitjes të së dhjetës.

<sup>62</sup> Haxhi Shkoza, *Financat e Shqipërisë 1839-1934*, Tiranë: Nikaj, 1935, f. 3-4.

<sup>63</sup> *Po aty*, f. 53.

Drejtoria e Financave ngriti sistemin e kontabilitetit të përgjithshëm, të kontrollit financiar, të sekretarisë, protokollit, arkivin dhe arkën e përgjithshme me një personel të kufizuar. Doganat vepronin afër vendit ku mbaheshin rezervat e ushtrisë. Në Drejtorinë e Financave kishte një Inspektor të Përgjithshëm si dhe një kontrollor të financave. Inspektori i Përgjithshëm merrte njoftime nga raportet e drejtorit dhe për rastet kur bënte vërejtje i shënonte në raportet e tij drejtuar komandës austro-hungareze në Shqipëri. Të gjitha librat dhe regjistrat e llogarive, rregullorja e taksës së të dhjetave, rregullorja e tatimit mbi fitimin dhe urdhëresat e ndryshme të kësaj fushe u përkthyen në gjuhën shqipe. Ligjet e vergjisë u modifikuan, nisën të bëheshin regjistrimet e pasurive dhe të tatim-fitimit. Ligjet e doganave dhe rregulloret e sistemit tatimor që ishin zbatuar që në periudhën e Perandorisë Osmane, u ruajtën, pasi ato ishin hartuar mjaft mirë nga ana e një specialisti britanik. Drejtoria e Përgjithshme e Financave në Shkodër arriti që të ndërtonte një sistem të centralizuar për mbledhjen e taksave. Në saje të punës së Drejtorisë së Financave në Shkodër, vetëm për vitin 1916, në territorin e Shqipërisë që gjendej nën administrimin austro-hungarez u mbledhën 5 milionë e 652 mijë korona të ardhura nga taksat e tatimet, ndërkohë që shpenzimet për mbajtjen e administratës vendore arrinin në 2 milionë e 51 mijë korona<sup>64</sup>.

Arritja e këtyre ndryshimeve u realizua falë punës këmbëngulëse të konsullit të Përgjithshëm, A. Kral, i cili arriti të kapërcente të gjitha pengesat, “për hir të shqiptarizimit absolut të shërbimit administrativ në Shqipëri”. Ai më mirë pranoi që procedura për ngritjen e një sistemi efikas tatimor shqiptar të zhvillohej pak më ngadalë dhe me humbje në të ardhura, “vetëm për të arritur qëllimin e lartë të nacionalizimit të jetës politike”. A. Kral mendonte se për shmangien e sistemit të çrregullt tatimor në Shqipëri dhe të dallimeve të theksuara në pagesën e taksave ndërmjet banorëve të krahinave të ndryshme të vendit, kërkohej që në të ardhmen të ndërmerrej një aksion i madh dhe i pandërprerë. Në këndvështrimin e tij, zhvillimi i sistemit tatimor kishte rëndësi kapitale për zhvillimin ekonomik e financiar të vendit si dhe ishte kusht i domosdoshëm për ekzistencën e një Shqipërie autonome<sup>65</sup>. Falë kësaj pune të përkushtuar, ku një meritë të veçantë pati drejtori i Përgjithshëm i

<sup>64</sup> F. Alizoti, *Kujtimet e jetës sime...*, f. 102-103, 106.

<sup>65</sup> *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 27-5-552*. Raport i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 30 shtator 1917.

Financave, Fejzi Alizoti, i cili ishte titullari i të gjithë administratës civile shqiptare, u arrit ndërtimi i një sistemi tatimor të tillë, i cili arriti të krijonte edhe rezerva financiare nga ana e disa zyrave financiare në rrethe (distrikte). Në këto raste, zyrat vartëse pasi kryenin të gjitha detyrimet dhe pagesat e parashikuara, ishin të detyruar të realizonin kthimin e tepricave financiare në arkën e Drejtorisë së Përgjithshme të Financave në Shkodër<sup>66</sup>.

Për të siguruar një administrim më të mirë dhe unik të financave në Shqipëri si dhe për t'i dhënë mundësi Komandës ushtarake austro-hungareze në Shqipëri, që të ushtronte vazhdimisht një kontroll mbi veprimtarinë financiare të administratës shqiptare, në fund të muajit qershor 1917, qeveria austro-hungareze vendosi që të emëronte Leopold Tominiç me detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm të Financave të Shqipërisë, i cili deri atëherë, kishte mbajtur detyrën e drejtorit të Financave të Korpuskomandës XIX në Shkodër. Funksionet e kontrollit financiar të ushtruara deri atëherë nga inspektori shqiptar i financave i kaluan Tominiç-it, me argumentin se ai njihte parametrat e një administrate financiare moderne, por edhe se ai duhej të ishte një organ vartës i besueshëm i Korpuskomandës XIX në Shqipëri. Urdhëresat që u dërgoheshin zyrave vartëse nënshkruheshin nga inspektori i Përgjithshëm i Financave si dhe nga drejtori i Financave të vendit, ndërsa raportet e inspektimeve nënshkruheshin vetëm nga inspektori i Përgjithshëm<sup>67</sup>. Drejtuesit e administratës financiare vendosën zbatimin e procedurave të rregullta për mbledhjen e taksave nga popullsia shqiptare. Kryekomanda e ushtrisë austro-hungareze i detyroi mydirët të ndihmonin dhe të mbikëqyrnin veprimet e taksildarëve dhe të dhjetarëve për mbledhjen e taksave e detyrimeve të tjera<sup>68</sup>. Pagesat e taksave dhe tatimeve të parashikuara për një vit, realizoheshin në katër këste. Pas pagesës së detyrimeve në korona austro-hungareze, administrata u lëshonte banorëve dëftesa të rregullta për pagesat e detyrimeve të tyre. Për rastet e

<sup>66</sup> *AQSH*, F. 271, V. 1917, D. 8, fl. 50. Shkresë e Zyrës së Përgjithshme të Financave, drejtuar Zyrës së Financave në Elbasan, Shkodër, më 8 Nanduer 1917.

<sup>67</sup> *HHSStA*, PA, A, në *AIH*, Vj. 27-1-166. Shkresë nr. 131 e Ministrisë së Punëve të Jashtme, drejtuar Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Vjenë, 28 qershor 1917.

<sup>68</sup> *AQSH*, F. 271, V. 1917, D. 10, fl. 44. Shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Financave, drejtuar nënprefekturës Elbasan, Shkodër, 21 maj 1917.

mosshlyerjes në kohë të detyrimeve, parashikohej zbatimi i parimit të kamatëvonesës<sup>69</sup>.

Drejtoria e Përgjithshme e Financave në Shkodër u ndesh me problemin nëse duhej të ruhej apo jo, privilegji i të drejtës së timarit për familjet e pasura shqiptare që vazhdonte ende në Shqipëri. Pasi analizoi me kujdes këtë çështje, më 17 qershor 1916, kjo drejtori kundërshtoi privilegjin e timarit, pasi ajo nuk e konsideronte të drejtë ruajtjen e mëtejshme të tij. Ruajtja e kësaj të drejte kishte kosto financiare për shqiptarët dhe arkën publike, prandaj heqjen e saj, drejtuesit e kësaj drejtorie e mbështetën mbi këto argumente; *së pari*, e drejta e timarit kishte lindur në një periudhë historike, kur shteti osman vendosi t'i shpërblente spahinjët për kontributin në luftëra dhe shërbimet e tyre në ushtri. Mirëpo, meqenëse nga autoritetet drejtuese nuk kërkohet më ky lloj shërbimi, shpërblimi i tyre financiar ishte i pajustificuar; *së dyti*, në bazë të së drejtës ndërkombëtare, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, kjo e drejtë konsiderohej "ipso jure" e shfuqizuar. Mbështetur sa më sipër, administrata financiare e Shqipërisë vendosi që të çlirohej nga privilegjet e mëparshme me synim "shëndoshjen e financave të shtetit të ri". Ajo nxiti Komandën e lartë ushtarake në Shqipëri, që të lëshonte një urdhër më 4 korrik 1916, në të cilin thuhej se nga kjo datë e në vazhdim nuk do të ekzistonte më privilegji i timarit<sup>70</sup>. Që nga kjo periudhë, familjet e pasura myslimane shqiptare nuk kërkuan më pagesa mbështetur në privilegjin e timarit, i cili rëndonte mbi financat e familjeve të tjera shqiptare. Masat e marra në këtë drejtim nga autoritetet shqiptare dhe ato austro-hungareze patën rëndësi në historinë e Shqipërisë në dy drejtime kryesore. Me këtë akt, autoritetet ushtarake austro-hungareze i bënë favor interesit të lartë kombëtar dhe shtetit shqiptar, pasi nga njëra anë, u arrit që të viheshin nën kontroll familjet e pasura e të privilegjuara që kishin fituar këtë status që nga periudha e ekzistencës së spahinjve dhe nga ana tjetër, nxiti njerëzit e shquar që rridhnin nga këto familje, që të hynin në shërbimin e administratës kombëtare shqiptare, duke marrë detyra me rëndësi, si oficerë të ushtrisë

<sup>69</sup> *Po aty*, F. 235, V. 1917, D. 25/1, fl. 216. Dëftesë detyrimi për shtetasit, lëshuar nga Administrata e Financave të Shqipërisë, Krujë, më 18 korrik 1917.

<sup>70</sup> *HHSStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 28-4-428. Raport i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar kontit Stefan Burian, ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 20 qershor 1918.

kombëtare, drejtues të xhandarmërisë dhe funksionarë e nëpunës në të gjitha nivelet.

Kisha Katolike e drejtuar nga imzot Serreqi kërkonte përjashtimin nga taksat për pasuritë e patundshme, ato të ushqimit dhe të së dhjetës, mbështetur në marrëveshjen e hershme të arritur midis Perandorisë Osmane dhe Francës. Mbështetur në të njëjtin argument se, Shqipëria ishte shkëputur nga Perandoria Osmane dhe që prej vitit 1913 ajo ishte njohur si shtet i pavarur, drejtuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Financave në Shkodër, kërkuan që Kisha Katolike në Shqipëri të mos përjashtohej nga pagesa e taksës për pasuritë e patundshme, taksës të së dhjetës si dhe kërkoi që njësoj si të gjithë shqiptarët edhe kleri katolik t'i nënshtrohej detyrimit të rekuizimit për tepricat e ushqimit. Fejzi Alizoti këmbënguli në parimin që nëse në një vend multifetar si Shqipëria, privilegje të tilla i jepeshin klerit katolik, ato duhej t'u jepeshin njësoj edhe klerit mysliman dhe ortodoks. Kjo çështje iu paraqit komandës austro-hungareze dhe për njoftim iu referua edhe drejtorëve të tjerë. Komanda ushtarake zhvilloi një takim të përbashkët me përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe drejtuesve të administratës civile shqiptare. Fillimisht, Luigj Gurakuqi doli në mbështetje të përjashtimit të Kishës Katolike nga taksat, por pasi drejtuesit e komandës dhe A. Kral pranuan pikëpamjen e F. Alizotit, edhe ai pranoi t'i bashkohej këtij qëndrimi. Pas këtij vendimi, komanda austro-hungareze mori masa efektive për të mos lejuar përjashtimin e Kishës Katolike nga pagimi i taksave dhe tatimeve<sup>71</sup>.

Problemi më i madh financiar që u krijua në Shqipëri gjatë viteve 1916-1918 dhe që pati pasoja të rënda për ekonominë dhe jetesën e shqiptarëve, ishte zhvlerësimi i koronës, monedhës austro-hungareze. Gjatë kësaj periudhe, në Shqipëri qarkullonin monedha të vendeve dhe periudhave të ndryshme, të paktën që nga shek. XIX<sup>72</sup>. Zhvlerësimi i monedhës austro-hungareze në Shqipëri ishte shumë më i madh se në vendet e tjera. Komisari civil, Kral, mendonte se shkaqet kryesore të zhvlerësimit të monedhës austro-hungareze ishin: *së pari*, popullsia shqiptare nuk kishte besim në kartmonedhën e këtij vendi; *së dyti*, ishin përpjekjet e forcuara për të grumbulluar arin e shqiptarëve nga

<sup>71</sup> F. Alizoti, *Kujtimet e jetës sime...*, f. 103.

<sup>72</sup> *HHStA, PA, A, në AIH, Vj. 26-3-332*. Shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme, drejtuar kontit Thurn, si dhe ambasadës austro-hungareze në Stamboll, Vjenë, 18 shkurt 1916.

administrata, por edhe në rrugë private nga ushtarakët dhe civilët austro-hungarezë; *së treti*, këmbëngulja e autoriteteve austro-hungareze për të paguar shqiptarët në kartëmonedhë, kur ata blinin ose rekuizonin artikujt e monopolit dhe ato ushqimorë; *së katërti*, pagesat e detyruara të kryera në monedha sermi turke, greke dhe bullgare për nevojat që kishte ushtria; *së pesti*, stanjacioni i tregëtisë normale, i cili nuk lejonte daljen e të hollave jashtë vendit për veprimtari tregtare; *së gjashti*, zhvillimi i tregtisë në Shqipëri, realizohej shpeshherë përmes këmbimit në natyrë të produkteve ose mallrave. Në mënyrë të veçantë, në këtë drejtim ndikoi hedhja në qarkullim e shumave të mëdha në kartëmonedhë nga Austro-Hungaria dhe fuqi të tjera pushtuese, zhvillimi i këmbimit të mallit në natyrë dhe këmbëngulja e popullsisë shqiptare për t'i qëndruar besnike mexhides serme osmane. Këta faktorë ndikuan në krizën e rëndë financiare, ku valuta austro-hungareze u bë e pavlerë në Shqipëri<sup>73</sup>.

Qarqet ushtarake mendonin se zhvlerësimi i monedhës austro-hungareze vinte për disa shkaqe kryesore. *Së pari*, deri në fillim të Luftës së Parë Botërore, në Shqipëri qarkullonin monedha ari të të gjitha shteteve. Kjo dukuri ndodhte për shkak se shqiptarët njësoj si të gjithë popujt orientalë nuk parapëlqenin përdorimin e kartëmonedhave për zhvillimin e veprimtarisë tregtare; *së dyti*, pas pushtimit të Malit të Zi, qeveria austro-hungareze nxori urdhrin për zhvlerësimin e kartëmonedhave malazeze dhe serbe në masën 50 për qind. Ky urdhër shqetësoi popullsinë shqiptare, e cila më pas nuk pati më besim te kartëmonedhat; *së treti*, si rrjedhojë e mungesës së monedhave në metale të çmuara që u vu re pas okupimit austro-hungarez të Shqipërisë, me një shumë të caktuar kartëmonedhash, popullsia shqiptare nuk arrinte të blinte të njëjtën sasi produktesh, krahasuar me atë që mund të merrte me monedhat e metaleve të çmuara<sup>74</sup>. Ndryshe nga Komisari civil, Kral, drejtuesit e ushtrisë austro-hungareze e shihnin këtë çështje në një këndvështrim pak më të ndryshëm. Shkakun kryesor të zhvlerësimit të monedhës së shtetit të tyre, ushtarakët përpiqeshin që ta kërkonin te prapambetja e shqiptarëve dhe jo te situata e krijuar nga abuzimet e kryera nga trupat ushtarake austro-hungareze. Për shkak të diferencës në

<sup>73</sup> *Po aty*, Vj. 27-2-236. Raport i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 1 dhjetor 1917; *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. III, f. 99.

<sup>74</sup> *Po aty*, Vj. 27-2-252. Referat mbi Shqipërinë dhe rregullimin e gjendjes valutore në krahinat e okupime të Ballkanit, Baden, 19 dhjetor 1917.

vlerë që u krijua mes kartëmonedhave dhe monedhave të çmuara, u thellua edhe më tepër kriza financiare dhe ekonomike në viset shqiptare. Megjithatë, nga kriza financiare, arriti të përfitonte një pjesë e vogël e shqiptarëve, e cila për shkak të rritjes së çmimeve dhe spekulimeve në këmbimin e monedhave, grumbulloi kapitale të mëdha monetare<sup>75</sup>.

Vështirësia e dytë e madhe që u shfaq gjatë viteve të luftës, ishte mungesa e produkteve ushqimore. Gjatë periudhës së okupimit austro-hungarez të Shqipërisë, çmimet e produkteve ushqimore pësuan rritje të madhe. Kjo rritje vështirësoi gjendjen ekonomike dhe sociale të shqiptarëve, e cila çoi në një nga krizat më të rënda humanitare në historinë moderne të shqiptarëve. Ajo u shoqërua me shfaqjen e urisë në mesin e popullsisë shqiptare të krahinave të ndryshme të vendit<sup>76</sup>. Periudha e krizës së rëndë humanitare e viteve 1916-1918, njihet nga shqiptarët me emërtimin “Koha e Nemces”<sup>77</sup>. Një nga faktorët kryesorë që shkaktoi krizën e urisë në mesin e shqiptarëve gjatë Luftës së Parë Botërore, ishte rekuizimi me forcë i drithërave dhe i ushqimeve të popullsisë shqiptare. Për shkak të vdekjeve të shumta nga uria të popullsisë shqiptare në bezirket e Shqipërisë së Jugut, një grup përfaqësuesish shqiptarë mes të cilëve edhe G. Cilka u shprehën të gatshëm të shkonin në Amerikë, përmes kalimit nëpër Sofje për të kërkuar nga shqiptarët e SHBA dërgimin e një vapori me artikuj ushqimorë<sup>78</sup>. Komisari civil, A. Kral, doli kundër abuzimeve të autoriteteve ushtarake në Shqipëri që bënë në këtë drejtim, ndaj popullsisë shqiptare. Ai u ankua tek eprorët e tij se kundrejt çështjes shqiptare, komanda ushtarake në Shqipëri synonte vetëm shfrytëzimin me plan dhe pa skrupull të vendit dhe banorëve të Shqipërisë vetëm në funksion të plotësimit të nevojave ushtarake<sup>79</sup>.

<sup>75</sup> *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. III, f. 99.

<sup>76</sup> *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-12-1281. Telegram shifër i Burian, ministrit të Punëve të Jashtme, drejtuar Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Vjenë, 31 mars 1916.

<sup>77</sup> Fjala “Nemce” rrjedh nga gjuha serbe, e cila në këto vite, gjeti përdorim edhe të popullsisë shqiptare. Me emërtimin “nemce”, popullsia serbe identifikonte popullsinë austriake, e cila fliste gjuhën gjermane, që nuk mund të kuptohej nga serbët (S. Kadria).

<sup>78</sup> *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-12-1277. Shkresë e kontit Thurn, drejtuar baronit Burian, ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Teschen, 25 mars 1916.

<sup>79</sup> *Po aty*, Vj. 28-8-832. Raport tepër sekret i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 11 maj 1918.

Krahas arritjeve të shënuara në fushën e tatimeve, gjatë viteve 1916-1917, u realizuan edhe investime të rëndësishme financiare nga ana e qeverisë austro-hungareze. Investimet e kryera nga kjo qeveri në territorin e okupuar të Shqipërisë, “në kurriz të buxhetit që shkonte për mobilizimin ushtarak, arrinin në 62 milionë korona”<sup>80</sup>. Prirja e qeverisë austro-hungareze për të kryer investime në viset shqiptare, bëhej me qëllim që të tërhiqte simpatinë dhe mbështetjen e popullsisë shqiptare ndaj saj. Ndjekja e kësaj politike ekonomike, shkaktoi pakënaqësi tek autoritetet drejtuese hungareze. Kryeministri hungarez Sándor Wekerle kritikoi ashpër investimet e kryera në Shqipëri. Lidhur me këtë, pikë së pari, ai kërkoi “që të sqarohet çështja, se me iniciativën dhe me autorizimin e kujt u banë këto investime të mëdha në tokat shqiptare të okupueme...”<sup>81</sup>. Sipas tij, mbështetur në kuadrin ligjor me të cilin operonin buxheti dhe financat e Perandorisë së Austro-Hungarisë, të hollat që u investuan në Shqipëri, qeveria hungareze “i kishte vënë në dispozicion, vetëm për të mbuluar nevoja të paevitueshme gjatë luftës”. Mirëpo, qeveria hungareze nuk mund të pranonte që falë mbështetjes financiare të qeverisë së Perandorisë, t’i jepej një përparësi e tillë, zhvillimit të ekonomisë së Shqipërisë. Kryeministri hungarez u shpreh se ishte kategorikisht kundër kësaj politike, pasi “nuk mund të mbante përgjegjësi për faktin që në një kohë, kur të ardhurat e shtetit u përdorën në Shqipëri për investime dhe të dalunat (shpenzimet) në buxhetin tonë janë kufizue në një masë të gjanë, duhet me pezullue gati krejt veprimtarinë investues shtetnore, pikërisht për me sigurue nevojat e mobilizimit”<sup>82</sup>.

Për shkak të kritikave ndaj politikës së investimeve që u realizua në Shqipëri, si dhe mbështetur në përparimin e shënuar në mbledhjen e të ardhurave si dhe përvojën e fituar nga administrata fiskale në Shqipëri, qeveria austro-hungareze vendosi të ndryshonte qëndrimin e saj në këtë drejtim. Në gusht të vitit 1918, Ministria e Punëve të Jashtme në Vjenë, u kërkoi autoriteteve të administratës ushtarake në Baden, që të ndërmermin procesin e hartimit të një buxheti të rregullt për territorin e okupuar të Shqipërisë. Administrata duhej ta fillonte punën e saj, me “hartimin e një preventivi të detajuar të të ardhunave dhe të dalunave

<sup>80</sup> *Po aty*, Vj. 27-2-230. Notë e kryeministrit hungarez i ngarkuar me drejtimin e financave, drejtuar Ministrisë së Luftës, 16 nëntor 1917.

<sup>81</sup> *Po aty*.

<sup>82</sup> *Po aty*.

financiare të Shqipërisë për vitin 1918”<sup>83</sup>. Ajo udhëzonte që të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e administratës vendore të Shqipërisë, të përfshiheshin në një buxhet autonom, i cili duhej të ishte pjesë përbërëse e buxhetit të Ministrisë së Luftës, me emërtimin “M-9 dhe nën një rubrikë të veçantë “ALB”. Për këtë arsye, Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë austro-hungareze kërkoi që Drejtoria e Përgjithshme e Financave në Shkodër në bashkëpunim me të gjitha zyrat e saj në Shqipëri “të formonin një kontabilitet autonom”. Pas mbledhjes së të ardhurave nga taksat dhe tatimet e shqiptarëve, të gjitha shpenzimet ushtarake dhe civile që kryheshin në viset shqiptare, për ndërtimin e rrugëve, urave dhe për mirëmbajtjen e tyre, duhej të llogariteshin në ngarkim të financave të Shqipërisë<sup>84</sup>.

Përmirësimi i sistemit të mbledhjes së taksave e tatimeve, investimet e kryera në disa sektorë me përparësi për qëllimet ushtarake, nevoja për mbajtjen me ushqime të ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri, nxiti zhvillimin e disa veprimtarive ekonomike në vend. Gjatë kësaj periudhe u rrit prodhimi i punishteve të vajit, mullinjve të blojës, furrave të bukës, kriporeve e të tjera<sup>85</sup>. Nga ana tjetër, një numër më i madh shqiptarësh u punësuan në administratën civile vendore, në punë publike dhe në njësitë ushtarake që vepruan në mbështetje të trupave austro-hungareze. Kjo rriti të ardhurat e një pjese të popullsisë shqiptare dhe të një grupi të vogël tregëtarësh.

Në mbarim të luftës, kur trupat austro-hungarezë u larguan nga Shqipëria, ato morën me vete një shumë prej 18 milionë koronash austro-hungareze, që gjendej e depozituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Financave në degën e “Wiener Bankverein” në Shkodër. Gjithashtu, ato morën me vete rreth 8 milionë korona që gjendeshin në zyrat e financave të rretheve dhe komunave në zonën austro-hungareze të okupimit në Shqipëri<sup>86</sup>.

<sup>83</sup> *Po aty*, Vj. 27-1-163. Shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme, drejtuar kontit von Storck në Baden, Vjenë, 9 gusht 1918.

<sup>84</sup> *Po aty*, Vj. 28-8-822. Shkresë e shefit të Shtabit të ushtrisë austro-hungareze, drejtuar Komandës së Korparmatës XIX në Shkodër, 26 gusht 1918.

<sup>85</sup> *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. III, f. 98.

<sup>86</sup> *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX ...*, f. 407; F. Alizoti, *Kujtimet e jetës sime...*, f. 107.

*S u m m a r y*

ON SEVERAL ISSUES OF POLITICAL AND FINANCIAL ADMINISTRATION  
OF THE TERRITORY OF ALBANIA OCCUPIED BY AUSTRIA-HUNGARY DURING  
1916-1918

This paper aims to focus on some historical aspects of the role and impact of Austro-Hungarian occupation among Albanians during the second half of the “Great War” period. In addition to the severe consequences that Albania experienced during World War I, the Austro-Hungarian presence in Albania in these years had also a positive impact in several key directions, such as: establishing an efficient centralized administration, setting up a national educational and cultural system, which was reflected in the establishment of Albanian schools, publications of books and newspapers in Albanian language, sending dozens of Albanian young people to study at the Austrian universities, the establishment of the Language commission, which laid the marks of the Albanian standard language, the construction of roads, bridges, building a narrow railway network, post-telegraph offices, the realization of population’s census. The implementation of the Western model by the local administration under the Austro-Hungarian control helped the Albanians in their efforts to rebuild the national state in later years.

From 1916 onwards in Albania, a new financial structure was created, consisting of Albanian employees, who implemented the modern financial management practices. During this period, all books of financial accounts, tithing and profit tax regulations, and various commands of this field were translated into Albanian language. During the years 1916-1917, the investments made by the Austro-Hungarian government in the occupied territory of Albania amounted to 62 million Kronen. In August 1918, a regular autonomous budget for the occupied territory of Albania was launched, which was an integral part of the War Ministry budget.